



## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **SPITALI FERIZAJ**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **220-20-6824-5-2-1; 039-2020**

Sa i përket tenderit: **Renovimi i objektit të ish-IKSHP- se për shërbime specialiste për Spitalin e Përgjithshëm Ferizaj** trimave

### ANKESË

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

*Finaling Shpk&NNP Euro construction&NTSH EdiFloor*  
(Emri i Operatorit Ekonomik)

*RR. Mbreti Genc, Blloku C, Nr.7, Prishtine*  
(Adresa)

*Prishtinë,*  
(Vendi)

10000  
(Kodi postar)

*044677322*  
(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

*Afrim Morina*  
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

Info.finalingshpk@gmail.com

(Adresa elektronike)

18.11.2020  
(Data e parashtrimit të ankesës)



(Nënshkrimi dhe vula)

#### 2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtoj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë: 28.10.2020

Afati i fundit për dorëzimin e tenderit: 03.11.2020

Njoftimi mbi vendimin e AK-së: 05.11.2020

Kërkesa për rishqyrtim me dt:10.11.2020

Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim me dt:10.11.2020

### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☒

Jo ☐

### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

### 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Bashkangjitur keni kërkesën për rishqyrtim dhe vendimin e AK-së për refuzim të kërkesës për rishqyrtim.



## 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

Neni 1 i LPP-së  
Neni 6 i LPP-së  
Neni 7 i LPP-së  
Neni 10 i LPP-së  
Neni 59 i LPP-së  
Neni 60 i LPP-së  
Neni 64 i LPP-së  
Neni 69 i LPP-së  
Neni 72 i LPP-së

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjabë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstalon që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

## 8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

Të nderuar, autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit na ka dërguar letrën standarde për tenderues të eliminuar me dt:05.11.2020, ku na ka eliminuar me arsyetimin se

**Paramases sone i kane munguar tri pozicione si: A.9, A10 dhe A11.**

Në lidhje me arsyen e eliminimit tonë, pozicionet ne fjale kane qene jashte paramasës dhe rikapitulimit total te ofertes dhe ne nuk e dimë se si mund te ofrohet çmim ne pozicione te cilat nuk kane as njesi e as sasi.

Këto rubrika nuk kanë pasur asnjë njësi apo sasi të cekur, prandaj këto rubrika boshe pa asnjë të dhënë si p.sh sasi, njësi etj, nuk kanë qenë obligative të plotësohen por kanë qenë në formë shablloni të mbetur. Këto rubrika AK-ja tani i shfrytëzon në vlerësim sipas dëshirës së tyre dhe i interpreton sipas dëshirës së tyre dhe duke na eliminuar neve me këtë arsyetim pa bazë ligjore. Po të shikohet paramasa e OE të rekomanduar për kontratë kuptohet dhe vërehet që ky OE ka ofruar çmime simbolike për ato pozicione, prandaj me veprimet e AK-së në dyshojmë se AK-ja ka përgatitur një grackë apo lojë që të diskriminojë OE tjerë, ndërsa të favorizojë OE e rekomanduar për kontratë.

Ne si kompani me dt. 06.11.2020 kemi kerkuar qasje ne dokumentacionin e kompanise se rekomanduar per kontratë dhe permes telefonit na eshte konfirmuar qe me dt. 09.11.2020 prej ores 9:00 mund të qasemi ne dokumentat e kerkuara.



Pas qasjes ne dokumentacionin e kompanise fituese ne kemi verejtur disa shkelje te cilat jane kerkuar ne FTD.

1. Ne FTD eshte kerkuar qe OE te sjelle nje liste te ATK-se per tri vitet e fundit me se paku 15-20 punetor ndersa operatori i rekomanduar per kontrate ka sjell vete nje list per 4 muajt e pare te vitit 2020 dhe listat tjera nuk e kane te cekur as vitin as daten kur jan nxej dhe jane perseritje e njera tjetres.  
Pra ne FTD eshte kerkuar lista e punetoreve per tri vitet e fundit, kurse OE i rekomanduar per kontrate ka ofruar nje liste vetem per katër muajt e parë të vitit 2020. Ofrimi i këtyre dëshmime nuk është në përputhje me kërkesën e FDT-së, sepse kërkesa ka qenë që të ofrohen dëshmi për tri vite të fundit. Një kompani mund ti ketë shumë më shumë punëtorë në katër muajorin e parë të vitit 2020 mirëpo të mos ketë asnjë punëtorë gjatë tri viteve të kaluara. Por në këtë rast është kërkuar q të dihet se a ka pas punëtorë në tri vitet e fundit për tu parë dhe vërtetuar se a ka staf të mjaftueshëm të punëtorëve dhe stabilitet në aspektin profesional, e që këtë kërkesë OE i rekomanduar për kontratë nuk ka arrit ta dëshmojë dhe argumentojë, prandaj duhet eliminuar ky OE si i papërgjegjshëm.
2. Ne FTD eshte kerkuar nje menaxher i projektit i cili duhet te jete inxhinier i ndertimtarise ose inxhinier i arkitektuar ndersa kompania e rekomanduar per kontrate ka ofruar vetem nje diplome te inxhinieri dhe nuk ka ofruar vendim per emerimin e menaxherit. Edhe këtë kërkesë OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka përmbushur, prandaj është dashur të eliminohet sipas nenit 59.4 të LPP-së sepse oferta e OE të rekomanduar për kontratë nuk është në harmoni të plotë me kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.
3. Ne FTD kerkohet qe OE te ofroj ne liste te kontratave te realizuar ne tri vitet e fundit dhe te deshmoj me referenca qe ka kryer se paku tri pune te lemise nje njejte (ndertim-renovim) ndersa operatori ekonomik ka ofruar disa kontrata me disa operator privat dhe nuk ka ofruar asnje deshmi mbi perfundimin me sukses te atyre puneve.  
OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar edhe këtë kërkesë sepse nuk ka ofruar asnjë dëshmi konkrete për përfundimin e kontratave të cilat i ka prezantuar, prandaj në mungesë të këtyre dëshmime ky OE duhet të shpallet i papërgjegjshëm.  
Kontratat e ofruara me OE privat dyshojmë se janë fiktive sepse për këto kontrata nuk është ofruar asnjë transaksion bankar si dëshmi se me të vërtetë janë realizuar, prandaj në mungesë të transaksioneve bankare kontratat e tilla nuk mund të merren si të vlefshme dhe nuk mund të llogariten se janë realizuar.  
Në mungesë të këtyre dëshmime OE i rekomanduar për kontratë është dashur të eliminohet automatikisht, madje në mungesë të këtyre dëshmime nuk lejohet që të kërkohej sqarime shtesë.

Si perfundim ne konstatojme qe OE i rekomanduar per kontratë nuk ka plotësuar asnjërin nga kriteret e kerkuar ne Dosjen e tenderit gjegjesisht ne FTD dhe tek njoftimi për kontratë.

Ne, në të njëjtën ditë që e kemi paarshtuar kërkesën për rishqyrtim me dt.10.11.2020 kemi pranuar edhe vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim, fakt ky që tregon se nuk është bërë asnjë analizë dhe asnjë shqyrtim i pretendimeve tona ankimore. Në këtë përgjigje AK-ja vetëm i ka përsëritur arsyet e eliminimit dhe i ka arsyetuar veprimet e saja në njoftimin mbi vendimin e saj.

Përfundimisht autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit nuk e respektuar nenin 59 të LPP-së, sepse na ka eliminuar neve si kompani edhe pse i kemi plotësuar të gjitha



kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë, ndërsa e kemi plotësuar edhe kriterin kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas nenit 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.

AK-ja me këtë vlerësim dhe vendim na ka diskriminuar neve në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së dhe njëkohësisht e ka favorizuar operatorin ekonomik të rekomanduar për kontratë, ndërsa në paragrafin 1 të nenit 7 të LPP-së parashihet qartë “Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”,

Autoriteti kontraktues është dashur të merr në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Gjithashtu autoriteti kontraktues nuk e ka respektuar edhe nenin 6 të LPP-së, sepse është dashur të sigurohet që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP që të merr:

#### **VENDIM**

**APROVOHET** ankesa e OE Finaling Shpk” & “NNP Euro Construction” & “Edi Floor” NSHT, si e bazuar,

**ANULOHET**, njoftimi dhe vendimi i AK-së për dhënie të kontratës dhe lënda kthehet në RIVLERËSIM,

**DETYROHET** autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

#### **9. Dëmet materiale**

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, në vlerë prej 5,000.00 €.

#### **10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura**

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.

- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.

**\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.**